



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**V E N D I M**

**Nr. 184, Datë 12/12/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 68, datë 11.06.2019, e z. A. M., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se z. A. M. ka përfunduar studimet 5-vjeçare për shkenca politike, në Universitetin “Miqësia e Popujve”, Rusi. Mbështetur në Dëshminë për Njohje të Diplomimit Nr. Regjistri 5101, datë 03.08.2011, të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, rezulton se Diploma e z. A. M., është njohur në nivelin “Master i Shkencave në Shkenca Politike”.

Nëpërmjet Vendimit nr. 641 prot., datë 26.09.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, z. A. M. është emëruar në pozicionin inspektor hetimi në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Në fillim të vitit 2017, ankuesi ka kaluar në pozicionin e inspektorit të zbatimit pranë Sektorit të Zbatimit, pranë Drejtorisë

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Rajonale Tatimore Tiranë, ku ka punuar deri në muajin maj 2019, moment në të cilin njoftohet nga punëdhënësi, për zgjidhje të marrëdhënieve të punës, për shkak të ndryshimeve strukturore të institucionit. Nëpërmjet shkresës nr. 9592/1, datë 23.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve rezulton se kontrata e tij e punës (me afat të pacaktuar), është zgjidhur për shkaqe të justifikuara. Referuar shkresës së sipërpërmendur, rezulton se motivacioni për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin, ka qenë mospërmbushja e kriterëve të veçanta të pozicionit të punës.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se inspektorët e tjerë, që punojnë në të njëjtin sektor me të kanë arsim në fusha të ndryshme dhe ata janë mbajtur në punë, ndërkohë që punëdhënësi ka ndërprerë marrëdhëniet e punës vetëm me të, që ka arsimim në shkencat politike. Në këtë kontekst, z. A. M. pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 68, datë 11.06.2019, së Z. A. M., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>2</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 937, datë 13.06.2019, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni ankuesit, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
  - 1.** Kopje e kontratës dhe librezës së punës së ankuesit;
  - 2.** Kopje e urdhërave të emërimit të ankuesit, në të gjitha pozicionet e punës, që ka mbajtur pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

---

<sup>2</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

3. Praktika e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin, ku të përfshihen: Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, Proçesverbali i takimit dhe Vendimi për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
  4. Informacion nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore, si dhe kopje të akteve përkatëse;
  5. Kopje të vlerësimeve në punë të ankuesit, përgjatë viteve, që ka punuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë;
  6. Numri i përgjithshëm i punonjësve, që janë larguar nga puna nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në kuadër të zbatimit të ristrukturimit të institucionit;
  7. Numri i inspektorëve në Sektorin e Zbatimit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë që janë larguar nga puna, me të njëjtin motivacion, sikurse ankuesi;
  8. Kopje e përshkrimit të punës së pozicionit të inspektorit në Sektorin e Zbatimit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; (para ristrukturimit të fundit)
  9. Kopje e përshkrimit të punës së pozicionit të inspektor në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; (para ristrukturimit të fundit)
  10. Kopje e përshkrimit të punës së pozicionit të inspektorit pranë Sektorit të Monitorimit Territorial, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; (pas ristrukturimit të fundit)
  11. Kopje e strukturës organike të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, para dhe pas ristrukturimit të fundit;
  12. Kopje e Urdhërit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të ndryshuar;
  13. Kopje e Urdhërit nr. 171, datë 13.05.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për miratimin e organigramës të Administratës Tatimore Qendrore”;
1. Në përgjigje të shkresës nr. 937, datë 13.06.2019, të Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgoi shkresën nr. 11871/1, datë 01.07.2019, nëpërmjet së cilës informon si më poshtë:

*Në lidhje me pikën 1* – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar bashkëlidhur shkresës nr. 11871/1, datë 01.07.2019, kopje të kontratës individuale të punës, librezës së punës dhe vërtetimeve të lëshuara nga ISSH.

*Në lidhje me pikën 2* – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar kopje të vendimit nr. 641, datë 26.09.2016 “Për emërim në detyrë” dhe Vendimit nr. 316, datë 09.03.2017 “Për emërim në detyrë” për z. A. M..

Në lidhje me pikën 3 – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar shkresën nr. 9592 prot., datë 10.05.2019 “Njoftim për zhvillimin e takimit me punëdhënësin në lidhje me kontratën individuale të punës me afat të pacaktuar”, Proçesverbali i datës 14.05.2019, shkresa nr. 9592/1 prot., datë 23.05.2019 “Për zgjidhjen e kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”;

Në lidhje me pikën 4 – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka sqaruar se ndaj ankuesit nuk është marrë ndonjë masë disiplinore, gjatë periudhës së ushtrimit të detyrave funksionale në Administratën tatimore Qendrore;

Në lidhje me pikën 5 - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar Formularët e Vlerësimit në Punë për periudhat 01 janar – 31 dhjetor 2017 dhe 01 janar – 31 dhjetor 2018;

Në lidhje me pikat 6 dhe 7 – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka sqaruar se në zbatim të strukturës organizative të Administratës Tatimore Qendrore, të miratuar me Urdhërin nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore””, të ndryshuar, kritereve arsimore për pozicionet e punës në strukturat e hetimit tatimor, të mirëpërcaktuara në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, e ndryshuar, ndodhur edhe para faktit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së për Auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, njoftuar me shkresën nr.280/1 Prot., datë 21.11.2018, protokolluar pranë DPT me nr. 4540/39, datë 23.11.2018, ku shprehimisht citohet: “Të merren masat për zbatimin e kritereve të posaçme të rregullores për procedurat e rekrutimit edhe për punonjësit e rekrutuar për para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe eliminimin e standardit të dyfishtë brenda administratës shtetërore”, si dhe në zbatim të Urdhërit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit, mbi ndryshimet strukturore, Punëdhënësi, nga verifikimi i dosjeve, diplomave zotëruese të punonjësve ka konstatuar mospërputhshmërinë e kriterit arsimor të përcaktuar me diplomat zotëruese të 11 punonjësve të strukturave të hetimit tatimor.

Në lidhje me pikat 8, 9 dhe 10 – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka sqaruar se pozicionet e punës së inspektorëve të Administratës Tatimore Qendrore rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës. Detyrat e tyre funksionale parashikohen në nenin 105 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore dhe në Manualin e Hetimit Tatimor;

Në lidhje me pikat 11, 12 dhe 13 – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar bashkëlidhur Urdhërin nr. 126, datë 02.08.2016, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe

të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore”, Urdhërin nr. 86, datë 03.05.2019, i Kryeministrit, “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126, datë 02.08.2018, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore””, si dhe Urdhërin nr. 171, datë 13.05.2019, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për miratimin e organigramës së Administratës Tatimore Qendrore”.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave për shqyrtimit administrativ të ankesës, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 12.09.2019, pranë KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi A. M. dhe përfaqësuesja me autorizim e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila depozitoi aktin e përfaqësimit Autorizim nr. 168/6, datë 10.09.2019, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm të Tatimeve.

Z. A. M. parashtrori edhe një herë pretendimet e tij për diskriminim, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ankuesi u shpreh se ka filluar punë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në vitin 2016. Ai sqaroi se ka përfunduar studimet 5-vjeçare për shkenca politike, në Universitetin “Miqësia e Popujve”, Rusi. Mbështetur në Dëshminë për Njohje të Diplomimit Nr. Regjistri 5101, datë 03.08.2011, të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Diploma e tij është njohur në nivelin “*Master i Shkencave në Shkenca Politike*”. Gjatë marrëdhënieve të punës, kanë ndryshuar kriteret arsimore për pozicionin e tij të punës. Në vitin 2017, për pozicionin e tij të punës (inspektor zbatimi) kërkohej arsimi për shkenca ekonomike ose juridike, por jo më arsim në shkenca sociale. Ai theksoi faktin se pas largimit nga puna u vu në dijeni të faktit se Rregullorja e Brendshme e institucionit kishte ndryshuar dhe se kriteret për punësim gjithashtu nuk janë më të njëjtat. Aktualisht, në këto kriteret përfshihet arsimi në shkenca shoqërore për inspektorët e zbatimit. Ankuesi solli në vëmendje të Komisionerit faktin se inspektorë të tjerë, që kanë patur gjendje arsimore të njëjtë me të, janë mbajtur në punë dhe janë sistemuar pas ristrukturimit, ndërkohë që ai është larguar nga puna. Z. A. M. u shpreh se vlerësimet e tij kanë qenë shumë të mira dhe në një testim të kryer në vitin 2018, në institucionin ku ai punon, ai është renditur i pari në listën e konkuresve. Ai theksoi faktin se pas zgjidhjes së kontratës së tij të punës, në datën 07.08.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka shpallur 6 (gjashtë) pozicione të lira pune për inspektorë zbatimi, ku si kriter arsimore janë përcaktuar shkencat sociale, ekonomike dhe juridike. Njëkohësisht, ai i bëri me dije përfaqësuesit e KMD-së se numri i inspektorëve pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë ishte rritur nga 72 inspektorë të përcaktuar në strukturën organike të vitit 2017, në 74 pozicione inspektorësh të përcaktuara në strukturën organike të vitit 2019.

Në këtë seancë dëgjimore, ankuesi u informua nga përfaqësuesit e KMD-së mbi faktin se, në kushtet kur, inspektorë të tjerë tatimorë, të cilët kanë patur arsimin e tij, apo arsimim në shkenca të tjera sociale janë mbajtur në punë, ndërkohë që ai është larguar nga puna, shkak i diskriminimit të

pretenduar, që është gjendja arsimore e ankuesit, nuk është i vlefshëm. Njëkohësisht, ai u bë me dije se identifikimi i saktë i shkakut të diskriminimit është tepër i rëndësishëm, ndërkohë që një çështje administrative me objekt konstatim diskriminimi, është në proces hetimi dhe shqyrtimi nga KMD.

Përfaqësuesja me autorizim e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u shpreh se pas kryerjes së ndryshimeve strukturore të këtij institucioni janë kryer edhe ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Brendshme. Pozicioni i inspektorit në sektorin ku ka punuar më parë ankuesi, aktualisht parashikon si kriter arsimor shkencat ekonomike dhe juridike. Ajo u shpreh se si rrjedhim i mosplotësisht të kriterit arsimor janë kryer zgjidhje kontratë me 3 (tre) punonjës të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, që nuk plotësonin kriterin arsimor.

Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën përfaqësuesen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëse ankuesi mund të ishte pozicionuar në një sektor tjetër të inspektimit tatimor, ku kriteri për shkencë sociale ishte ende kriter punësimi. Përfaqësuesja e këtij institucioni u shpreh se si rrjedhim i ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë suprimuar disa pozicione pune, përkatësisht nga 45 pozicione inspektorësh të përcaktuar me strukturën organike të vitit 2017, në 27 pozicione të tilla pune, të përcaktuara në strukturën e vitit 2019. Inspektorët e larguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet ristrukturimit, janë sistemuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Përfaqësuesja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve theksoi faktin se Sektori i Zbatimit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë është suprimuar dhe në vend të tij është krijuar Sektori i Monitorimit Territorial.

Në vijim, përfaqësuesit e KMD-së kërkuan informacion mbi disa çështje, për të cilat u ra dakord, që do të dërgoheshin në vijim në rrugë zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgoi shkresën nr.17898 prot., datë 26.09.2019, nëpërmjet së cilës informon Komisionerin, se z. A. M. ka ushtruar detyrat funksionale në pozicionin Inspektor Zbatimi, në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor-Rajoni Qendror, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, kategoria e pagës IV-a.

Me shkresën nr. 9592/1 Prot., datë 23.05.2019 *“Për zgjidhjen e kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ankuesit i është zgjidhur kontrata e punës, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të veçanta, përkatësisht kriterit arsimor, të pozicionit të punës.

Në zbatim të strukturës organizative të ATQ<sup>3</sup>, të miratuar me Urdhërin nr. 86, datë 03.05.2019, e Kryeministrit, *“Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”*,

---

<sup>3</sup> ATM - Administrata Tatimore Qendrore;

të ndryshuar, janë suprimuar 14 pozicione pune në strukturat e hetimit tatimor. Titullari i institucionit, në mbështetje të neneve 19 dhe 20 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, Urdhërit nr. 65/2, datë 14.05.2019 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor””, të ndryshuar, si dhe duke respektuar dhe zbatuar rekomandimet përkatëse në Raportin të KLSH-së “Për auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, njoftuar me shkresën nr. 280/1 Prot., datë 21.11.2018, protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Nr. 4540/39, datë 23.11.2018, ku shprehimisht citohet: “Të merren masat për zbatimin e kriterëve të posaçme të rregullores për procedurat e rekrutimit dhe për punonjësit e rekrutuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe eliminimin e standardit të dyfishtë brenda administratës shtetërore”, me shkresën nr. 9587/1 Prot., datë 23.05.2019, ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për z. A. M., me arsyetimin e mospërbushjes së kriterëve arsimore, për pozicionet e punës në strukturat e hetimit tatimor. Z. A. M. zotëron diplomë të lëshuar nga Universiteti Miqësia e Popujve, Rusi, program 5 vjeçar, njehsuar nga MASH, si Master i Shkencave në shkencë politike. Referuar kriterëve arsimore të përcaktuara në nenin 5, të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, (të ndryshuar), ku përcaktohet “Inspektor zbatimi në Sektorin e Monitorimit në Terren”, kategoria e pagës IV-a, duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në Shkencë Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion.” Ndodhur në kushtet e detyrimit ligjor për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, si dhe të ndodhur para faktit të ristrukturimit të ATQ-së, Drejtori i Përgjithshëm ka zgjidhur kontratën e punës, duke respektuar procedurën dhe afatet e njoftimit.

Referuar dispozitave të Kodit të Punës dhe Rregullores në fuqi, emërimi ose zgjidhja e kontratës së punës është shprehje e vullnetit të lirë të palëve konform procedurave ligjore.

Për sa citohet në ankesën e Z. A. M., lidhur me shpalljen e vendeve vakante në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sqarohet se Rregullorja “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, e ndryshuar, mirëpërcakton procedurat ligjore, për rekrutimin/plotësimin e vendeve vakante në strukturat e hetimit tatimor, në momentin e krijimit të tyre. Zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi me punëmarrësin nuk është vijim apo procedurë, e cila lidhet me shpalljen dhe rekrutimin në strukturat e hetimit tatimor. Zgjidhja e kontratës së punës është bërë për shkaqe dhe nisur nga faktorë konkretë, ndërsa shpallja për konkurim në strukturat e hetimit tatimor, i përket vendeve vakante në Rajonin Jugor, si dhe përfshin të gjitha vendet vakante në këtë rajon, duke përcaktuar edhe kriterin arsimor për pozicion dhe kategori page konkrete. Në këtë kontekst, sqarohet fakti se procedura e ristrukturimit nuk përfshiu vetëm strukturat e

hetimit tatimor, por edhe struktura të tjera të Administratës Tatimore Qendrore, në ndryshim të emërtesave të tyre apo numrit të personelit.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në respektim të dispozitave ligjore në fuqi, janë zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në rrugë elektronike, në datën 07.05.2019, ka njoftuar stafin për miratimin e ndryshimeve strukturore dhe për procedurat e mëtejshme.

Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor, në pozicione pune të trajtuara me dispozitat e Kodit të Punës, janë njoftuar zyrtarisht, për zhvillimin e bisedimeve me punëdhënësin. Më konkretisht, z. A. M. është njoftuar për zhvillimin e takimit me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, nëpërmjet shkresës nr. 9592 Prot., datë 10.05.2019, të DPT. Në takimin e zhvilluar në datën 14.05.2019, vërtetuar me procesverbalin e mbajtur gjatë takimit, z. A. M. i është bërë me dije se kontrata e punës për shkak të procedurës së ristrukturimit është në shqyrtim, fakt i pranuar edhe nga vetë ankuesi.

Rrjedhimisht, aktet nënligjore në fuqi do të rishikohen dhe do të përshtaten, sipas emërtesave, detyrave funksionale të reja, të strukturave të Administratës Tatimore Qendrore.

Në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sqarohet se për sa u pretendua dhe u kërkua gjatë seancës dëgjimore të realizuar pranë KMD-së, në zbatim të Strukturës Organizative të Administratës Tatimore Qendrore, të ndryshuar, Drejtoritë e Hetimit Tatimor, në rajone, përbëheshin nga Sektorët e Analizës, Sektorët e Hetimit Tatimor dhe Sektorët e Zbatimit. Sipas Urdhërit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit, i cili solli ndryshime në Strukturën Organizative, Drejtoritë e Hetimit Tatimor, në Rajone, aktualisht përbëhen nga Sektorët e Hetimit Tatimor dhe Sektorët e Monitorimit Territorial. Në momentin e miratimit të ndryshimeve strukturore, Sektori i Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor-Rajoni Qendror, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, kishte në përbërje të tij 22 pozicione pune Inspektor Zbatimi, kategoria e pagës IV-a, (asnjë pozicion vakant) dhe 44 pozicione pune Inspektor Zbatimi, kategoria e pagës IV-b (asnjë pozicion vakant).

Me ndryshimet strukturore, Sektori i Monitorimit në Terren, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Rajoni Qendror, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ka në përbërje 24 pozicione pune inspektor, kategoria e pagës IV-a dhe 44 pozicione pune inspektor, kategoria e pagës IV-b.

Nisur nga fakti i suprimimit të 11 pozicioneve pune në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, titullari i institucionit, në mundësi objektive sistemoi punonjësit, të cilët përmbushnin kriterin arsimor në pozicione me kategori page ekuivalente, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, si dhe vendosi zgjidhjen e kontratës së punës për punonjës, të cilët nuk përmbushnin kriterin arsimor.



Konkretisht, pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor – Rajoni Qendror, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë u sistemuan 7 punonjës, me të dhënat sipas tabelës bashkëlidhur.

Bashkëlidhur shkresës së DPT, është dërguar edhe Urdhëri nr. 65, datë 04.10.2017, i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, si dhe procesverbalit i datës 14.05.2019, mbi takimin e zhvilluar midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

2. Në vijim të seancës dëgjimore, në datën 30.09.2019, ankuesi A. M. solli parashtrimet e tij me shkrim, ku përveç shkakut të diskriminimit “gjendja arsimore”, ankuesi nxjerr pretendime edhe mbi një shkak tjetër të përcaktuar në LMD, atë të përkatësisë në një grup të veçantë. Përkatësia në një grup të veçantë e ankuesit, lidhet me grupin e atyre studentëve shqiptarë, që kanë përfunduar studimet e larta në Rusi.

Në parashtrimet e ankuesit citohet shprehimisht: “Unë ankuesi Z. A. M. kam mbaruar studimet e larta dhe zotëroj Diplomë të nivelit të dytë, Master Shkencor në Shkencat Politike, lëshuar nga Universiteti “Miqësia e Popujve”, Rusi. Duke pasur parasysh situatën politike dhe marrëdhëniet midis Rusisë, Bashkimit Evropian, situatave të krijuara në ballkanin perëndimor si dhe vete marrëdhënieve Rusi-Shqipëri, për të gjithë shtetasit që kanë mbaruar studimet e larta në Rusi ka një diferencim. Këtë fakt e kam ndjerë dhe e kam vuajtur që nga momenti që jam kthyer në Shqipëri dhe kam kërkuar të futem në tregun e punës. Nga statistikat e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve rezulton se asnjë nga studentët që kanë studiuar në Rusi nuk ka mundur të gjej punë në Rusi apo vendet e BE dhe një pjesë e papërfillshme (në raport me studentët që ndjekin studimet atje) në Shqipëri.

Disa prej organizatave të shoqatës së Studentëve japin alarmin se studentët e huaj që studiojnë në Rusi rrezikojnë në 99% të rasteve të shantazhohen për të bashkëpunuar me shërbimet sekrete ruse GRU dhe SVR.

Ish student shqiptar që ka studiuar në MGIMO Rusi gjatë viteve të fundit rrëfen për Faktor.al se është kontaktuar nga punonjës të Universitetit MGIMO dhe i kanë premtuar se do ta ndihmojnë të sistemohet me punë në Shqipëri ose në një nga vendet e BE-së nëse vendos të bashkëpunojë me Shërbimet sekrete ruse. Studenti shqiptar (që kërkon të mbetet anonim) i gjetur në vështirësi nuk i kishte dhënë përgjigje dhe disa ditë më vonë thirret në Zyrën e Dekanit dhe i njoftohet përjashtimi nga Universiteti i MGIMO dhe largimi i menjëhershëm i tij nga Rusia. <https://www.faktor.al › rreziqet-qe-u-kanosen-studenteve-shqiptare-ne-rus>.

Ish studente shqiptare që ka studiuar në Universitetin Miqësia e Popujve Rusi rrëfen për Faktor.al se ka aplikuar për punësim në administratën Shqiptare dhe pse është shpallur fituese asaj nuk i është dhënë mundësia të japë kontributin për të punuar për vendin e saj për shkak se

mbarimi i studimeve në Rusi e ka penalizuar. <https://www.faktor.al/2019/03/16/mbaron-studimet-ne-rusi-por-nuk-gjen-dot-pune-ne-shqiperi-historia-e-studenteve-shqiptare-ne-moske/>

*Jo më kot solla faktet e mësipërme. Duke qenë se Shqipëria ka prirje drejt perëndimit, lidhja me Rusinë dhe ndërhyrja e saj shikohen me një sy jo të mirë. Si rrjedhojë të parët që po e vuajnë këtë situatë jemi ne që kemi mbaruar studimet atje. Shumë herë është dashur të shmangem nga pyetjet e shpeshta në institucion rreth arsyeve se perse i kam mbaruar studimet në Rusi, duke u ndjerë kështu i diskriminuar për këtë fakt”.*

3. Në vijim të e-mailit të dërguar nga ankuesi A. M., Komisioneri i dërgoi zyrtarisht pretendimet e tij, për diskriminim, në adresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nga ku kërkoi prapësimet përkatëse, brenda datës 28.10.2019.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgoi prapësimet e saj nëpërmjet shkresës nr. 17898/1, datë 26.11.2019.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 68, datë 11.06.2019, së Z. A. M., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Në ankesën nr. 68, datë 11.06.2019, e Z. A. M., pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Mbështetur në provat e administruara rezulton se Z. A. M. ka përfunduar studimet 5-vjeçare për shkenca politike, në Universitetin “Miqësia e Popujve”, Rusi. Mbështetur në Dëshminë për Njohje të Diplomimit Nr. Regjistri 5101, datë 03.08.2011, të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Diploma e tij është njohur në nivelin “*Master i Shkencave në Shkenca Politike*”.

Nëpërmjet Vendimit nr. 641, datë 26.09.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Z. A. M. është emëruar në pozicionin inspektor hetimi, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Në vijim, në zbatim të Vendimit nr. 316, datë 09.03.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Z. A. M. është liruar nga detyra e

sipërpërmendur dhe është emëruar inspektor zbatimi me kategori page IV-a, në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë. Marrëdhëniet e punës ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit janë rregulluar nëpërmjet Kontratës Individuale të Punës së lidhur ndërmjet tyre, në datën 20.03.2017.

Në vitin 2017, u miratua Urdhëri nr. 65, datë 04.10.2017, i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor””. Në referencë të nenit 5, gërma d), të Urdhërit të sipërpërmendur parashikohen kritere të mirëpërcaktuara arsimore për pozicionet e inpektorëve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, pranë Drejtorive Rajonale Tatimore. Sipas rregullores, për inspektorët e Sektorit të Zbatimit pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, parashikohen kriteret si më poshtë vijojnë :

*“d. Sektori i Zbatimit*

.....

- *Inspektor Zbatimi III-b duhet të zotërojë diplomë Mastër Shkencor në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo më pak se 2 vjet përvojë pune në profesion.*
- *Inspektor zbatimi IV-a duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në Shkenca Ekonomike/Juridike dhe të ketë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion.*
- *Inspektor Zbatimi IV-b duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në Shkenca Ekonomike ose Juridike.*

Rregullorja e sipërpërmendur ka hyrë në fuqi pas emërimit të Z. A. M. në pozicionin e inspektorit të Zbatimit, me kategori page IV-a. Mbështetur në parashikimet e kësaj rregulloreje, ankuesi nuk plotësonte kriterin arsimor për pozicionin e tij të punës. Rregullorja e mësipëme parashikon si kriter arsimor në shkenca juridike ose ekonomike, për pozicionin e punës inspektor zbatimi në Drejtorinë e Hetimit Tatimor.

Për sa më sipër, në Raportin e Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve” njoftuar me shkresën nr. 280/1 Prot., datë 21.11.2018, protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Nr. 4540/39, datë 23.11.2018, citohet rekomandimi ku shprehimisht citohet: “Të merren masat për zbatimin e kritereve të posaçme të rregullores për procedurat e rekrutimit dhe për punonjësit e rekrutuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe eliminimin e standardit të dyfishtë brenda administratës shtetërore”.

Mbështetur në ndryshimet strukturore, si dhe në rekomandimin e lënë nga KLSH, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve zgjidhi kontratën e punës me Z. A. M.. Fillimisht ankuesit i është dërguar shkresa nr. 9592, datë 10.05.2019 “Njoftim për zhvillimin e takimit me punëdhënësin në lidhje me kontratën individuale të punës me afat të pacaktuar”, nëpërmjet së cilës ankuesi njoftohej për t’u paraqitur në takimin e datës 14.05.2019, me përfaqësuesit e punëdhënësit. Në vijim, Z. A. M. i dërgohet shkresa nr. 9592/1, datë 23.05.2019, e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, nëpërmjet së cilës kryhet zgjidhja e kontratës së punës me afat të pacaktuar, për shkaqe të justifikuara. Referuar informacionit të administruar rezulton se edhe 3 (tre) inspektorë të tjerë janë larguar nga puna me të njëjtin motivacion, sikurse ankuesi.

Në zbatim të strukturës aktuale të Administratës Tatimore Qendrore, të miratuar nëpërmjet Urdhërit nr. 86, datë 03.05.2019 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, (të ndryshuar), Drejtoria e Hetimit Tatimor (1+3+31+72) pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë<sup>4</sup> aktualisht përbëhet nga Sektori i Hetimit Tatimor (1+30+1) dhe Sektori i Monitorimit Territorial (1+1+26+46). Për sa më sipër rezulton se Sektori i Zbatimit dhe Sektori i Analizës që ishin krijuar nëpërmjet strukturës paraardhëse të këtij institucioni tashmë janë shkruar duke krijuar një sektor të vetëm të emërtuar Sektori i Monitorimit Territorial, në të cilin bëjnë pjesë 74 punonjës.

Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se numri total i pozicioneve të punës pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor nuk ka ndryshuar, pavarësisht ndryshimeve strukturore të ndodhura brenda kësaj drejtorie. Numri total i punonjësve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor ka qenë dhe mbetet 107 punonjës në total.

Mbështetur në Lidhjen Nr. 1 (1/2), të Urdhërit nr. 171, datë 13.05.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për miratimin e organigramës të Administratës Tatimore Qendrore” është kryer një ndarje e detajuar e punonjësve në secilën drejtori e sektorë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, duke specifikuar me hollësi edhe kategorinë e pagës për të gjithë punonjësit.

Sipas detajimit të strukturave përkatëse të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, pranë këtij institucioni rezulton se Sektori i Hetimit Tatimor përbëhet nga 32 punonjës (1 përgjegjës sektori - kategoria e pagës III-b) + 31 inspektorë (kategoria e pagës IV-a). Sektori i Monitorimit Territorial përbëhet nga 1 Përgjegjës Sektori (kategoria e pagës III-b), Zyra e Koordinimit, ku bëjnë pjesë 1 përgjegjës zyre (kategoria e pagës III-b) dhe 4 inspektorë (kategoria e pagës IV-a), si dhe Zyra e

<sup>4</sup> Sipas strukturës organike në fuqi, Drejtoria e Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë përbëhet nga 107 punonjës në total.

Veprimeve në Terren dhe Masave Administrative që përbëhet nga 24 inspektorë me kategori page IV-a dhe 44 inspektorë me kategori page IV-b.

Pas miratimit të strukturës së mësipërme organike, nëpërmjet Urdhërit nr. 65/2, datë 14.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”” rezulton se janë ndryshuar sërish kriteret arsimore për rekrutimin e inspektorëve të zbatimit në Sektorin e Monitorimit në Terren dhe Masave Administrative kanë ndryshuar. Neni 5, i kësaj Rregulloreje parashikon, si vijon:

*“- Inspektor në Zyrën e Veprimeve në Terren dhe Masave Administrative IV-a duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në shkenca Ekonomike, Juridike ose Shoqërore dhe të ketë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion.*

*-Inspektor në Zyrën e Veprimeve në Terren dhe masave Administrative IV-b duhet të zotërojë minimalisht diploma Bachelor në Shkenca Ekonomike, Juridike ose ekzakte.*

*-Inspektor zbatimi në Sektorin e Monitorimit në Terren IV-a duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion.*

*-Inspektor Zbatimi në Sektorin e Monitorimit në Terren IV-b duhet te zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në Shkenca Ekonomike, Juridike, Shoqërore ose Ekzakte”.*

Në bazë të këtyre ndryshimeve në Rregullore konstatohet lehtësisht se Z. A. M. i plotëson kriteret arsimore për t’u sistemuar në një pozicion analog, pavarësisht se me ulje të kategorisë së pagës nga niveli IV-a në nivelin IV-b, brenda sektorit të ri me emërtesën “Sektorin e Monitorimit Territorial”, i cili sikurse u përmend edhe më sipër është vetëm një bashkim/shkrirje e ish-Sektorit të Analizës me ish-Sektorin e Zbatimit, ku më parë kishte punuar ankuesi A. M..

Komisioneri ka konstauruar gjithashtu se data e miratimit të Urdhërit të sipërpërmendur për ndryshimin e Rregullores është **14.05.2019**, datë, e cila përkon me datën në të cilën është zhvilluar takimi me Z. A. M., për të diskutuar vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin, janë zhvilluar gjatë një periudhe kohore, kur ndryshimet në Rregullore kishin hyrë në fuqi. Në këtë mënyrë, ankuesit i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, ndërkohë që ka ekzistuar mundësia për t’u sistemuar brenda këtij institucioni, edhe pse ky sistemim do të shoqërohej me ulje të kategorisë së pagës, nga VI-a në VI-b. Shkresa, nëpërmjet së cilës ankuesi njoftohet për zgjidhje të marrëdhënieve të punës është 23.05.2019, datë që përkon me periudhën pas miratimit të ndryshimeve në rregullore.

Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se në kushtet, kur ndryshimet organike dhe strukturore të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nuk prekin numrin total të punonjësve të saj, që sërisht mbetet i njëjtë, mundësia për sistemim të Z. A. M. brenda strukturës, ku ai punonte më parë, duke marrë në konsideratë vlerësimet dhe eksperiencën e tij në punë, duket të ishte totalisht e realizueshme. Njëkohësisht, Komisioneri çmon se sqarimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, se sistemimi i ankuesit nuk ka qenë i mundur, pasi në disa prej pozicioneve të inspektorëve brenda Drejtorisë së Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, janë sistemuar disa inspektorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilëve u është suprimuar pozicioni i punës pranë këtij institucioni, nuk është i justifikueshëm dhe objektiv.

Komisioneri gjykon se fillimisht duheshin sistemuar inspektorët e Sektorit të Zbatimit apo Sektorëve të tjerë, pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të cilëve u janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me motivacionin e mosplotësimit të kriterit arsimor, e në vijim mund të mendohej dhe të krijohet mundësia për sistemim të inspektorëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që u është suprimuar vendi i punës, si pasojë e ristrukturimit.

Në këtë kontekst, në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”, Komisioneri krijon bindjen e arsyeshme se z. A. M. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

Në ankesën nr. 68, datë 11.06.2019, e Z. A. M., pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

“Gjendja arsimore” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë,

*gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, Komisioneri gjykon se këto shkaqe konsiderohen si shkaqe të mbrojtura, pasi parashikohen si të tilla në bazën ligjore të sipërpërmendur.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë e disfavorizues me shkaqet e mbrojtura.**

#### **C/1. Lidhja e trajtimit të padrejtë e disfavorizues me “gjendjen arsimore”.**

Z. A. M. pretendon për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Një pretendim i tillë presupozon se largimi i ankuesit nga puna është kryer për shkak të gjendjes së tij arsimore. Sikurse u konstatua edhe nga analiza në rubrikën e mësipërme rezulton se gjatë kryerjes së procedurave për zgjidhje të kontratës së punës me ankuesin, nëpërmjet Urdhërit nr. 65/2, datë 14.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, “*Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”*” kriteret arsimore për punësim të inspektorëve të zbatimit, pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë kanë ndryshuar, duke e përfshirë sërish kriterin arsimor në shkenca shoqërore, ku bën pjesë edhe diploma e Z. A. M.. Njëkohësisht, në referencë të publikimit në bërë në datën 07.08.2019, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me “Shpalljen për konkurrim për pranim në strukturat e Hetimit Tatimor”, nëpërmjet së cilit njoftohet hapja e procedurës për konkurim për pranim në strukturat e hetimit tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Rajoni Jugor, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, në kriteret e posaçme për kandidatët që do të marrin pjesë në konkurrim, përfshihet edhe kriteri arsimor në shkenca shoqërore, i cili ka qenë i përjashtuar më parë. Njëkohësisht, sikurse pranohet edhe nga vetë ankuesi, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, pas kryerjes së ristrukturimit janë mbajtur në punë inspektorë të tjerë, të cilët kanë patur arsimin e z. A. M..

Diskriminimi në vetëvete karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet

me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk e posedon karakteristikën e mbrojtur.

Faktet e sipërpërmendura e përjashtojnë lidhjen shkakësore ndërmjet gjendjes arsimore, në cilësinë e shkakut diskriminues, me qëndrimin e padrejtë dhe disfavorizues ndaj të cilit ankuesi është ekspozuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Në mungesë të lidhjes shkakësore ndërmjet qëndrimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e diskriminimit, nuk mund të këtë diskriminim të ankuesit për shkak të gjendjes së tij arsimore.

## **C/2. Lidhja e trajtimit të padrejtë e disfavorizues me përkatësinë në një grup të veçantë.**

Në informacionin e përcjellë nga ankuesi pranë Komisionerit, në vijim të seancës dëgjimore, është përcaktuar si shkak diskriminimi, përkatësia në një grup të veçantë. Grupi i veçantë përbëhet nga ata studentë shqiptarë, që kanë përfunduar studimet e larta dhe janë diplomuar jashtë Shqipërisë, në Universitetet e Rusisë. Në këtë kontekst, ankuesi e lidh dhe justifikon shkakun e ri të diskriminimit të pretenduar, me politikën e jashtme të ndjekur nga shteti shqiptar. Ai shprehet se në kushtet kur, Shqipëria është më e tërhequr dhe prirur nga Europa Perëndimore dhe e larguar nga Rusia, studentët shqiptarë që kanë studiuar në Rusi janë të diskriminuar për këtë shkak, për sa i përket rekrutimit e punësimit të tyre në administratën publike.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se nuk ekzistojnë fakte bindëse, që provojnë pretendimet e ankuesit. Përveç Z. A. M., si pasojë e ristrukturimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë u janë zgjidhur marrëdhëniet e punës edhe 3 (tre) inspektorëve të tjerë, që nuk rezultojnë të kenë përfunduar studimet në Rusi. Komisioneri gjykon se nëse do të ekzistonte realisht diskriminim për shkakun e mësipërm, z. A. M. nuk do të ishte punësuar në vitin 2016, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Njëkohësisht, në kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të rekrutimit të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe institucioneve të saj të varësisë, nuk bën pjesë asnjë kriter preferencial apo përjashtues, për ata studentë që janë diplomuar në universitete jashtë shtetit shqiptar dhe aq më tepër në Rusi.

Për sa më sipër, Komisioneri krijon bindjen e arsyeshme, se nuk ka lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, me trajtimin e padrejtë dhe disfavorizues ndaj të cilit, ai është ekspozuar.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, diskriminimi përkufizohet si: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo*



*pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Në mungesë të një lidhjeje të tillë, ndërmjet këtyre dy elementëve thelbësorë, që përcaktojnë diskriminimin e ndodhur, Komisioneri gjykon se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12 e 13, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. A. M., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

Fusha – punesim  
Shkak – gjendja arsimore, perkatesi ne nje grup te vecante